



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“KËRKIM, SHPIM DHE SHFRYTËZIM PËR NAFTË, GAZ DHE UJË”

X-IV-18

Niveli IV KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

Tiranë, Maj 2018

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	“Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë”			Kodi X-IV-18
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK	
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, është të përgatisë specialistë të nivelit Teknik/menaxher mesëm në fushën e kërkimit, shpimit dhe shfrytëzimit të naftës, gazit dhe ujit dhe t’i bëjë të aftë për t’u punësuar në veprimtaritë e menaxhimit të një reparti, sektori, linje prodhimi, brigade, ose njësie të ngjashme të kësaj fushe, apo për krijimin e menaxhimit të një biznesi privat, person fizik ose juridik si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë” të nivelit IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar arsimin profesional në një nga kualifikimet profesionale të nivelit III të KSHK, referuar nivelit III të KEK, të drejtimit “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë”; - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë” të nivelit IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës të këtij niveli që përkon me nivelin profesional Teknik/Menaxher në këtë fushë profesionale, të njohur në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në ndërmarrje të ndryshme private/shtetërore që ushtrojnë aktivitet në fushën e kërkimit, shpimit dhe shfrytëzimit të naftës, gazit dhe ujit. Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e kërkimit, shpimit dhe shfrytëzimit të naftës, gazit dhe ujit në profesionet: Teknik gjeolog, Teknik shpimi, Teknik shfrytëzimi, etj. Po ashtu, në varësi të profilit ai mund të punësohet në një biznes që operon në fushën e kërkimit, shpimit dhe shfrytëzimit të naftës, gazit dhe ujit, në sektorët e prodhimit dhe të mirëmbajtjes, etj. Përfundimi me sukses i arsimit profesional “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë” të nivelit të katërt në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e individit fiton të drejtën e Diplomës së Maturës Shtetërore Profesionale me mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin pas të mesëm, ose në nivelin e studimeve universitare			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	Nuk ka			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Në përfundim të kualifikimit profesional në drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë” të nivelit të katërt në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Të përgjithshme

- Të përgjithësojë rezultatet gjeologjike gjatë shpimit të puseve;
- Të japë përfundime për shqyrtimin, përpilimin dhe bashkërendimin e të dhënave gjeologjike me ato inxhinierike;
- Të përmbledhë treguesit dhe rreziqet gjeologjike gjatë shpimit të puseve dhe vënies në shfrytëzim të tyre;
- Të përshkruajë rëndësinë e përzgjedhjes së materialeve dhe lëndëve të para gjatë operacioneve të shpimit, nxjerrjes së naftës, gazit dhe ujit;
- Tu shpjegojë punonjësve dhe kolegëve praktikat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Të përshkruajë rehabilitimin e mjedisit pas braktisjes (abandonimit) të pusit;
- Të shpjegojë funksionet e pasimeve të ndryshme që përdoren në sondën e shpimit (pus).
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e marrjes së lejes për shpimin e një pusi;
- Të përshkruajë procesin e ecurisë së shpimit në tërësi gjatë thellimit të pusit dhe manovrave të ndryshme të tij;
- Të përgjithësojë mënyrën e organizimit të transportit të sondës;
- Të analizojë planin e zhvillimit të vendburimit dhe treguesit e përpunimit;

Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të shpjegojë komponentët përbërës dhe funksionet e uniformës dhe pajisjeve mbrojtëse personale VPMP;
- Të shpjegojë procedurën e kontrollit vizual të uniformës dhe pajisjeve mbrojtëse personale VPMP;
- Tu shpjegojë punonjësve dhe kolegëve praktikat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Te shpjegojë shenjat, tabelat paralajmëruese dhe shiritat për sigurimin e sheshit të pusit apo të zonës ku kryhen punime;
- Të shpjegojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë gjatë proceseve të punës;

- Të listojë rastet e mospërputhjeve me rregullat dhe rregulloret e SShP;
- Të shpjegojë procedurat e ndihmës së shpejtë në rast mospërputhjeje të rregullave dhe rregulloreve përkatëse të SShP;
- Të gjykojë për ndihmën e shpejtë në rast mospërputhjeje me rregullat dhe rregulloret përkatëse të SShP;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit në nivel ndërmarrje dhe më gjerë;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e instruktimit të rregullave të sigurimit teknik në mënyrë periodike;

Shpimi i puseve-organizimi i punës në kantier (sondë)

- Të përgjithësojë rezultatet gjeologjike gjatë shpimit të puseve;
- Të japë përfundime për shqyrtimin, përpilimin dhe bashkërendimin e të dhënave gjeologjike me ato inxhinierike;
- Të përmbledhë treguesit dhe rreziqet gjeologjike gjatë shpimit të puseve dhe vënies në shfrytëzim të tyre;
- Të përshkruajë projektin (programin) e shpimit të pusit;
- Të shpjegojë vendndodhjen e pikës së shpimit (sondës);
- Të shpjegojë ekipit (brigadës) hapat e procesit për montimin e sondës (kullës dhe gjithë pajisjeve të tjera) në pus;
- Të shpjegojë funksionet e pajisjeve të ndryshme që përdoren në sondën e shpimit (pus);
- Të shpjegojë pozicionin dhe detyrat përkatëse gjatë montimit të sondës për çdo anëtar të ekipit (brigadës) së shpimit;
- Të shpjegojë montimin dhe saldimin e linjave të pjesës sipërfaqësore të sistemit të qarkullimit të lëngut larës në pus;
- Të shpjegojë punimet elektrike në sondë dhe rreth saj (sipërfaqen e zyrave);
- Të shpjegojë hapat e kolaudimit e sondës përfshirë të gjitha pajisjet dhe nyjet e saj përbërëse;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e marrjes së lejes për shpimin e një pusi;
- Të shpjegojë faktorët që ndikojnë në ekuilibrin e presioneve midis pusit dhe shtresës duke përfshirë edhe presionet suplementare;
- Të shpjegojë gjetjen e recepturave të përpunimit kimik të lëngjeve larës në lidhje me vlerat absolute të parametrave të përcaktuara në projektin e shpimit të pusit;
- Të shpjegojë procedurat dhe matjet që kryhen për monitorimin e parametrave të lëngut larës;
- Të shpjegojë procedurat e trajtimit të shllamit;
- Të shpjegojë humbjet hidraulike të lëngut larës në sistemin e qarkullimit;

Mbikëqyrja e procesit të shpimit

- Të shpjegojë fushat e përdorimit të puseve të orientuar deri në horizontalë;
- Të përshkruajë format e trajektoreve të puseve të orientuar;
- Të përshkruajë veçoritë e teknologjisë për shpimin e puseve të orientuar deri në horizontalë;
- Të shpjegojë tipet e ndryshme të pajisjes së fundit të kolonës së shpimit gjatë shpimit të puseve të orientuar deri në horizontal;
- Të shpjegojë veçoritë e shpimit të puseve në det;
- Të shpjegojë veçoritë e shpimit për shfrytëzimin e ujërave nëntokësor;
- Të përshkruajë veprimet për aplikimin e regjimit të shpimit;
- Të listojë parametrat e lëngut larës nëpërmjet marrjes së kampionit analizues nga kanalet apo rezervuari i parë i grumbullimit të lëngut larës të dalë nga pusi;
- Të shpjegojë rëndësinë e pompimit të lëngut larës në pus;
- Të përshkruajë procesin e ecurisë së shpimit në tërësi gjatë thellimit të pusit dhe manovrave të ndryshme të tij;
- Të listojë parametrat e regjimit të shpimit nëpërmjet monitorëve në zyrën e kryesondistit dhe të inxhinierit të shpimit;
- Të përshkruajë masat për parandalimin e komplikacioneve dhe avarive gjatë procesit të shpimit të pusit;
- Të listojë hapat për marrjen e kampionit gjeologjik (shllamit) në kanalet e lëngut larës;
- Të qartësojë funksionet e kokës së çimentimit para fillimit të procesit të çimentimit;
- Të shpjegojë ecurinë e procesit të çimentimit të kolonave të rrethimit në pus;
- Të shpjegojë procesin e çimentimit të tapave të çimentos dhe tamponimeve;
- Të nënvizojë ndërhyrjet korrigjuese për gjendje parregullsie;
- Të vlerësojë karakteristikat e tretësirës së çimentos që po futet në pus;
- Të vlerësojë karakteristikat e gurit të çimentos që do të krijohet nga tretësira e çimentos;

Përfundimi i shpimit të pusit

- Të shpjegojë procedurat për provën e shtresës podhimitare dhe përvetësimin e pusit
- Të përshkruajë grafikët e provës së shtresës;
- Të shpjegojë procesin e heqjes (largimit) të lëngut larës të përdorur të ndodhur në rezervuarët e pusit;
- Të shpjegojë mbushjen e rezervuarëve të pusit me lëng larës të freskët ose ujë;
- Të shpjegojë kompletimin e pusit për vënien në shfrytëzim të tij;
- Të shpjegojë vendosjen e filtrit të shfrytëzimit të pusit;
- Të shpjegojë vendosjen e pakerit (taposësit të brendshëm) të kolonës së shfrytëzimit;
- Të përshkruajë demontimin e sondës së shpimit;
- Të përgjithësojë mënyrën e organizimit të transportit të sondës;
- Të përshkruajë ngarkimin e pjesëve përbërëse të sondës në mjetet e transportit;
- Të shpjegojë transportin e tubave të shpimit dhe elementëve të tjerë të kolonës së shpimit;

- Të shpjegojë vendosjen e filtrit të shfrytëzimit të pusit;
- Të shpjegojë vendosjen e pakerit (taposësit të brendshëm) të kolonës së shfrytëzimit;
- Të përshkruajë procedurat për braktisjen (abandonimin) e pusit;
- Të shpjegojë heqjen (largimin) e lëngut larës dhe ujit nga pusi;
- Të përshkruajë largimin e fazës së ngurtë të rezultuar nga pastrimi i lëngut larës;
- Të përshkruajë rehabilitimin e mjedisit pas braktisjes (abandonimit) të pusit;
- Të përshkruajë dokumentacionin përfundimtar të pusit;
- Të përshkruajë procedurat e dorëzimit të pusit prodhues apo shterpë në organizatën (kompaninë) operuese (investitori);

Marrja në dorëzim e puseve për shfrytëzimin e naftës dhe të gazit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të tyre (vënia e puseve në shfrytëzim)

- Të përshkruajë mënyrat e shfrytëzimit të vendburimeve të naftës;
- Të shpjegojë format e monitorimit dhe treguesit e shfrytëzimit të vendburimeve;
- Të analizojë ecurinë e treguesve të shfrytëzimit të puseve;
- Të analizojë mundësitë dhe kapacitete për maksimizimin e prodhimit të naftës dhe rritjen e koeficientit të naftënxjerrjes;
- Të analizojë planin e zhvillimit të vendburimit dhe treguesit e përpunimit;
- Të listojë masat për parandalimin e ndotjes në vendin e punës;
- Të listojë detyrat e tij si menaxher për praninë në vendin e punës të ekipit/brigadës;
- Të shpjegojë evidentimin e mirëmbajtjes periodike dhe kapitale të pajisjeve të puseve dhe punimeve të kryera në sipërfaqe;
- Të shpjegojë evidentimin e punimeve të kryera në trungun e pusit, në fund të pusit, në zonën pranë fundore dhe në shtresë;
- Të listojë të gjitha punimet në librin (biografinë) e pusit nga fillimi i procesit të shpimit deri në përfundimit të shfrytëzimit të pusit. (deri kur braktiset apo kalon në ruajtje);
- Të përshkruajë legjislacionin në përputhje me operacionet e industrisë së naftës për shpimin dhe shfrytëzimin e puseve në funksion të gjendjes së tyre dhe kriteret e kalimit në konservim;
- Të vlerësojë treguesit e shfrytëzimit të rezervuarëve të naftës, ujit, gazit mbajtës;
- Të analizojë të dhënat e mbledhura gjatë shfrytëzimit të puseve;
- Të listojë hapat e planit të zhvillimit të shfrytëzimit;
- Të analizojë metodat e shfrytëzimit të vendburimit dhe kompletimin mbi dhe nën tokësor të puseve;
- Të klasifikojë gjendjen e kolonës së shfrytëzimit;
- Të shprehet mbi nevojën e këmbimit të pompës së thellësisë dhe operacioneve të tjera të riparimit/remontit të zakonshëm dhe kapital të puseve;
- Të përshkruajë sipas legjislacionit kalimin e puseve të shpimit dhe të prodhimit të

abandonuara në konservim;

- Të përshkruajë gjendjen e puseve të shterur dhe atyre të braktisur prej vitesh;
- Të analizojë planin e rehabilitimit të tyre sipas një radhe të caktuar;
- Të shprehet për gjendjen ekzistuese të puseve të braktisur nëpërmjet inspektimit në vend të pusit dhe mjedisit rreth tij;
- Të rendisë pajisjet për rehabilitimin e pusit të braktisur sipas gjendjes së tij;

Menaxhimi dhe legjislacioni (Administrimi dhe drejtimi i punimeve)

- Të shpjegojë qëllimin e organizimit të organizatës (ndërmarrjes);
- Të përshkruajë format e ndryshme të organizimit të saj;
- Të shpjegojë mënyrën e organizimit dhe mbikëqyrjes së punës për drejtimin/menaxhimin e njësisve të prodhimit të organizatës (ndërmarrjes) ;
- Të përshkruajë organizimin e procesit të prodhimit (veprimtarisë), sipas posteve (vendeve) të punës, për punimet e kërkimit, shpimit si dhe deri në magazinimin e prodhimit të gatshëm për fushën e nxjerrjes së naftës;
- Të përshkruajë mënyrën e hartimit të urdhrave të punës për çdo situatë;
- Të përshkruajë mënyrën e instruktimit të punonjësve në njësi të ndryshme;
- Të shpjegojë mënyrat e planifikimit të aktivitetit prodhues;
- Të shpjegojë qëllimet e planifikimit;
- Të shpjegojë konceptet bazë financiare (dokumentet financiare, institucionet financiare);
- Të listojë komponentët e hartimit të një buxheti për një sipërmarrje të vogël;
- Të përshkruajë teknika mbështetëse për të menaxhuar dhe zbatuar në situatë të ndryshme;
- Të listojë mjetet e nevojshme për sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit, për të realizuar vendim-marrjen në biznes;
- Të përshkruajë elementët e përgjithshme të përcaktimit të kostos;
- Të përshkruajë konceptin e normimit të punës në përgjithësi, kohët kryesore dhe ndihmëse të punës në makineri ose pajisje;
- Të përshkruajë elementët e përcaktimit të çmimit;
- Të krahasojë çmimet e materialeve kryesore dhe atyre ndihmëse që përdoren në fushën kërkimit, shpimit dhe shfrytëzimit të naftës dhe gazit;
- Të shpjegojë ligjet e konkurrencës së ekonomisë së tregut;
- Të shpjegojë planin operacional dhe buxhetin;
- Të shpjegojë përcaktimin e rezervës së nevojshme materiale (lëndë të para, ndihmëse, etj.), për të mos penguar procesin e prodhimit;
- Të shpjegojë procedurën e organizimit të transportit të produktit përfundimtar, mjetet që përdoren, dokumentet kryesore të furnizimit apo shpërndarjes së prodhimeve, nga prodhuesi deri te konsumatori;
- Të interpretojë plan-vendosjet e reparteve dhe njësisve të prodhimeve, skemat e furnizimit të

- energjisë, të ujit, të telekomunikacionit, skemat e sistemit të sigurisë dhe mbrojtjes nga zjarri, të shkarkimeve të ujërave e të gazrave, të mbetjeve të ngurta;
- Të përshkruajë dokumentacionin teknik në shpimin e puseve dhe në nxjerrjen e naftës dhe gazit;
 - Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të punës, me theks të veçantë në të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe të punëmarrësit;
 - Të përshkruajë legjislacionin për kontratat e shërbimit dhe nën shërbimit;
 - Të përshkruajë legjislacionin për kontratat individuale dhe kolektive të punësimit;
 - Të listojë kuadrin ligjor dhe detyrimet administrative në biznesin;
 - Të përshkruajë dokumentacionin ekonomiko-financiar dhe juridik në shpimin e puseve dhe në nxjerrjen e naftës dhe gazit;
 - Të përshkruajë mënyrën e trajtimit dhe të ruajtjes së dokumentacionit;

Edukim profesional

- Të shpjegojë skemën organizative të burimeve njerëzore në tërë piramidën organizuese të ndërmarrjes;
- Të përshkruajë organizimin e ndërmarrjes ku bën pjesë duke nisur nga maja e piramidës e deri tek njësia bazë operative në industrinë e naftës;
- Të shpjegojë detyrat e ekipit punues për vendet e punës dhe në kohë dhe hierarkinë e punës;
- Të vlerësojë nevojat e trajnimit të anëtarëve të ekipit (njësisë) që punon (drejton);
- Të shpjegojë mënyrat e rekrutimit punëtorëve të rinj;
- Të shpjegojë rregullat e promovimit në detyra (rritjes) të organizatës përkatëse;
- Të përshkruajë metodat e vlerësimit dhe vetëvlerësimit të aftësive profesionale;
- Të shpjegojë kuptimin dhe nevojën për menaxhimin e burimeve njerëzore (personelit) në kuadrin e zhvillimit të qëndrueshëm të organizatës dhe shoqërisë ku bën pjesë ajo;
- Të gjykojë mbi trajnimin në vendin e punës për anëtarët e ekipit , praktikantët e rinj, punëtorët e rinj (për sigurinë dhe procedurat e pajisjeve me mjetet personale të punës);
- Të vlerësojë mendimet dhe sugjerimet e punëtorëve të ekipit (njësisë) mbi organizimin e punës dhe rezultatet e saj;
- Të shkëmbejë informacion bashkëkohor në rrjetet me inxhinierët e ndërmarrjes dhe profesionistët të miratuar të fushës ku punon;
- Të rendisë metoda të reja (inovative) të organizimit të punës në njësinë e vet dhe më gjere;
- Të theksojë mundësitë që ofron tregu i punës dhe kualifikimet e mëtijshme për vete dhe punëtorët;
- Të përshkruajë kuadrin ligjor dhe detyrimet administrative në biznesin e industrisë së naftës (kërkim, shpim, shfrytëzim dhe transport i naftës dhe i gazit).

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Të përgjithshme

- Të planifikojë operacionet e proceseve të ndryshme që zhvillohen në njësi;
- Të organizojë ekipin për kryerjen e detyrave sipas vendit të punës, në kohë dhe me cilësi;
- Të shpërndaje mjetet dhe pajisjet e punës sipas operacioneve përkatëse në kantier;
- Të instruktojë ekipin mbi operacionet që do të kryhen dhe rregullat e sigurimit teknik të nevojshme;
- Të vlerësojë hap pas hapi ecurinë e proceseve të punës;
- Të përcaktojë masat ndërhyrëse për normalizimin e operacioneve të punës;
- Të interpretojë të dhënat e operacioneve të ndryshme në konsulencë me inxhinierin;
- Të kujdeset për mjedisin ku veprojnë drejtpërsëdrejti punëtorët (venit të punës)
- si dhe mjedisin për rreth;

Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të përzgjedhë komponentët përbërës të uniformës dhe pajisjeve mbrojtëse personale VPMP;
- Të kontrollojë kushtet dhe funksionimin e uniformës dhe pajisjeve mbrojtëse personale VPMP;
- Të organizojë praktikat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Të vendosë shenjat, tabelat paralajmëruese dhe shiritat për sigurimin e sheshit të pusit apo të zonës ku kryhen punime;
- Të demonstrojë procedurat e ndihmës së shpejtë;
- Të analizojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë gjatë montimit të sondës së shpimit dhe pajisjeve të saj;
- Të analizojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të shpimit;
- Të analizojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të qarkullimit të lëngut larës;
- Të analizojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të tubimit të pusit dhe të çimentimit të kolonave të rrethimit;
- Të analizojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përgatitjes dhe përpunimit kimik të lëngut larës;
- Të vlerësojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë manifestimit të shenjave dhe informacionit për prishje të ekuilibrit hidrodinamik të presioneve shtresë-pus;

- Të analizojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të shërbimeve mirëmbajtëse të sondës së shpimit;
- Të analizojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të likuidimit të avarive;
- Të vlerësojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë fontanave të hapura të naftës dhe gazit;
- Të vlerësojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të përvetësimit të pusit;
- Të analizojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të shfrytëzimit të pusit;
- Të parashikojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të braktisjes (abandonimit) së pusit;

Shpimi i puseve -organizimi i punës në kantier (sondë)

- Të interpretojë rezultatet gjeologjike gjatë shpimit të puseve;
- Të vlerësojë treguesit dhe rreziqet gjeologjike gjatë shpimit të puseve dhe vënies në shfrytëzim të tyre;
- Të organizojë bashkërendimin e të dhënave gjeologjike me ato inxhinierike;
- Të interpretojë projektin (programin) e shpimit të pusit;
- Të dallojë vendndodhjen e pikës së shpimit (sondës);
- T'i komunikojë (brigadës) për procesin e montimit të sondës (kullës dhe gjithë pajisjeve të tjera) në pus;
- Të përzgjedhë pajisjet e ndryshme që përdoren në sondën e shpimit (pus);
- Të mbështesë punimet elektrike në sondë dhe rreth saj (sipërfaqen e zyrave);
- Të përcaktojë funksionet, montimin dhe saldimin e linjave të pjesës sipërfaqësore të sistemit të qarkullimit të lëngut larës në pus;
- Të specifikojë karakteristikat teknike të sistemit të qarkullimit të sondës;
- Të specifikojë karakteristikat teknike të sistemit të prodhimit të energjisë së sondës (motorëve);
- Të analizojë rezultatet e procedurave të kolaudimit të sondës përfshirë të gjitha pajisjet dhe nyjet e saj përbërëse;
- Të rishikojë kushtet e sigurimit teknik të çdo vendi pune të ekipit (brigadës) në sondë (ndriçim, pastërti, hapësirë etj.);
- Të zbatojë lejen që merret për shpimin e një pusi;
- Të vlerësojë faktorët që ndikojnë në ekuilibrin e presioneve midis pusit dhe shtresës duke përfshirë edhe presionet suplementare;
- Të demonstrojë procedurat e procesit të pastrimit të lëngut larës nga shllami;
- Të llogarisë humbjet hidraulike të lëngut larës në sistemin e qarkullimit;

- Të zbatojë procedurat për optimizimin e energjisë hidraulike dhe larjes së pusit;

Mbikëqyrja e procesit të shpimit

- Të specifikojë fushat e përdorimit të puseve të orientuar deri në horizontalë;
- Të vizatojë format e trajektoreve të puseve të orientuar;
- Të dallojë veçoritë e teknologjisë për shpimin e puseve të orientuar deri në horizontalë;
- Të specifikojë tipet e ndryshme të pajisjes së fundit të kolonës së shpimit gjatë shpimit të puseve të orientuar deri në horizontal;
- Të dallojë veçoritë e shpimit të puseve në det;
- Të specifikojë veçoritë e shpimit për shfrytëzimin e ujërave nëntokësor;
- Të demonstrojë veprimet për aplikimin e regjimit të shpimit;
- Të ndjekë procesin e ecurisë së shpimit në tërësi gjatë thellimit të pusit dhe manovrave të ndryshme të tij;
- Të hartojë masat për parandalimin e komplikacioneve dhe avarive gjate procesit të shpimit të pusit;
- Të organizojë procesin e çimentimit të kolonave të rrethimit në pus si dhe të të tapave të çimentos dhe tamponimeve;
- Të komunikojë inxhinierin për ecurinë e procesit të çimentimit (normalitetin apo parregullsitë e rastit);
- Të ndër marrë veprimet korrigjuese për gjendje të parregullta;

Përfundimi i shpimit të pusit

- Të zbatojë procedurat për provën e shtresës prodhimtare dhe përvetësimin e pusit;
- Të interpretojë grafikët e provës së shtresës;
- Të mbështesë heqjen (largimin) e lëngut larës të përdorur të ndodhur në rezervuarët e pusi dhe mbushjen e tyre me lëngut larës të freskët ose ujë;
- Të kryejë kompletimin e pusit për vënien në shfrytëzim të tij;
- Të vendosë filtrin në kolonën e shfrytëzimit të pusit;
- Të kryejë vendosjen e pakerit (taposësit të brendshëm) të kolonës;
- Të vlerësojë demontimin e sondës së shpimit;
- Të hartojë ngarkimin e pjesëve përbërëse të sondës në mjetet e transportit;
- Të organizojë transportin e tubave të shpimit dhe elementëve të tjerë të kolonës së shpimit;
- Të hartojë procedurat për braktisjen (abandonimin) e pusit;
- Të parashikojë masat për rehabilitimin e mjedisit pas braktisjes (abandonimit) të pusit;
- Të plotësojë dokumentacionin përfundimtar të pusit;
- Të realizojë dorëzimin e pusit prodhues apo shterpë në organizatën (kompaninë) operuese (investitori);

Menaxhimi dhe legjislacioni

- Të analizojë komponentët e hartimit të një buxheti për një sipërmarrje të vogël;
- Të zbatojë fazat e menaxhimit të një projekti (duke identifikuar burimet e nevojshme për një projekt të veçantë);
- Të përdorë teknika mbështetëse për të menaxhuar dhe zbatuar një projekt në situata të ndryshme;
- Të përdorë metoda të zgjidhjes së problemeve në kontekste të ndryshme;
- Të parashikojë mundësitë që ofron tregu i punës për kualifikime të mëtejshme;
- Të analizojë konceptin e ndërmarrjeve me përgjegjësi sociale në kontekste lokale dhe globale;
- Të aplikojë metodat e vlerësimit dhe vetëvlerësimin të aftësive profesionale;
- Të përcaktojë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit;
- Të analizojë kuptimin dhe nevojën për menaxhimin e burimeve njerëzore (personelit), duke u përqendruar në mënyrën e drejtimit, integritit, motivimit dhe mbikëqyrjes së tyre;
- Të aplikojë mjetet e nevojshme për sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit, për të realizuar vendim-marrje në biznes;
- Të vlerësojë dobinë e marketingut në biznes;
- Të zbatojë kuadrin ligjor dhe detyrimet administrative në biznes;
- Të përdorë elementët e përgjithshme të përcaktimit të kostos;
- Të zbatojë konceptin e normimit të punës në përgjithësi, kohët kryesore dhe ndihmëse të punës në makineri ose pajisje;
- Të aplikojë elementët e përcaktimit të çmimit;
- Të analizojë çmimet e materialeve kryesore dhe atyre ndihmëse që përdoren në fushën e naftës dhe gazit, sipas veçorisë së tyre për mënyrën e furnizimit, afatin dhe ciklin e përdorimit, volumin dhe mënyrën e magazinimit të tyre etj.;
- Të analizojë mënyrat e planifikimit të aktivitetit prodhues;
- Të analizojë Mbijetesën, Konkurrencën, Mundësitë dhe Lulëzimin e ndërmarrjes;
- Të analizojë planin operacional dhe buxhetin e njësisë ku punon;
- Të analizojë mënyrën e organizimit dhe mbikëqyrjes së punës për drejtimin/menaxhimin e njësisë të prodhimit si, ndërmarrje, sektorë, reparte, linja prodhimi, brigadë, etj.;
- Të hartojë urdhrat e punës;
- Të hartojë organizimin e procesit të prodhimit, sipas posteve të punës, deri në magazinimin e prodhimit të gatshëm;
- Të përcaktojë rezervën e nevojshme materiale (lëndë të para, ndihmëse, etj.), për të mos penguar procesin e prodhimit;
- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të punës, me theks të veçantë në të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe të punëmarrësit;
- Të zbatojë legjislacionin për kontrata e shërbimit dhe nënshërbimit (nënkontratat);
- Të zbatojë pjesë të plan-vendosjes të njësisë të prodhimeve, (skemat e furnizimit të

- energjisë, të ujit, të telekomunikacionit, skemat e sistemit të sigurisë dhe mbrojtjes nga zjarri, të shkarkimeve të ujërave e të gazrave, të mbetjeve të ngurta);
- Të hartojë dokumentacionin teknik në shpimin e puseve dhe në nxjerrjen e naftës dhe gazit;
- Të hartojë dokumentacionin ekonomiko-financiar në shpimin e puseve dhe në nxjerrjen e naftës dhe gazit;
- Të zbatojë rregullat e trajtimit dhe të ruajtjes së dokumentacionit;

Shfrytëzimi vendburimeve të naftës dhe gazit

- Të përzgjedhë mënyrat e shfrytëzimit të vendburimeve të naftës;
- Të organizojë format e monitorimit dhe treguesit e shfrytëzimit të vendburimeve;
- Të monitorojë ecurinë e treguesve të shfrytëzimit të puseve, të debitit, presionit dhe sasisë së ujit apo të rërës në fluid;
- Të organizojë të gjithë kapacitetet për të bërë të mundur rritjen e koeficientit të naftënxjerrjes me një shfrytëzim optimal të vendburimit;
- Të interpretojë planin e zhvillimit të vendburimit dhe treguesit e përpunimit;
- Të menaxhojë punët në vijueshmëri që së bashku me inxhinieret të përgatit raportin për mos ndotjen e vendit të punës;
- Të kryejë detyrat e tij si teknik për praninë në vendin e punës të ekipit/brigadës, evidentimin e mirëmbajtjes periodike dhe kapitale të pajisjeve të puseve dhe punimeve të kryera në sipërfaqe, në trungun e pusit, në fund të pusit, në zonën pranë fundore dhe në shtresë;
- Të ruajë e të mirëmbajë librin (biografinë) e pusit nga fillimi i procesit të shpimit deri në përfundim të shfrytëzimit të pusit. (deri kur abandonohet apo kalon në ruajtje);
- Të mirëmbajë kullat, agregatet, pajisjet sipërfaqësore e nëntokësore duke evidentuar dhe regjistruar gjendjen dhe masat për riparimin ose zëvendësimin e tyre.

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë dhe negociojë idetë e tij me të tjerët, në mënyrë eficiente;
- Të ndër marrë rol aktiv në promovimin e drejtësisë sociale dhe në përballje me diskriminimin në mjedisin e punës;
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të ndër marrë nisma për të zhvilluar ide të reja teknike dhe/ose menaxhuese duke i diskutuar paraprakisht me inxhinierin epror;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kriteret e drejta, për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij dhe të tjerëve;

- Të demonstrojë aftësi komunikim si me vartësit e tij (punëtorët e ekipit) dhe eprorët përkatës si dhe ekspertët e organizatave (kompanive) nënkontraktore me të cilat bashkëpunohet;
- Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në mjedisin e punës dhe me bashkësitë e komuniteteve që mirëpresin veprimtaritë industrialet;
- Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
- Të demonstrojë aftësi për të pranuar gabimet dhe dështimet dhe të bëjë përpjekje për ti ndrequr sa më parë dhe më mirë ato;
- Të tregojë aftësi për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet e njësisë që drejton.